



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



**Emërtimi i lëndës: Zhvillim i aftësive dëgjimore**

**Titullari / pedagogu i lëndës:** Dr. Sonila Piri; Dr. Alnida Koroshi

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore;

**Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:** Viti I / Semestri I

**Lloji i lëndës:** E detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [sonila.piri@unitir.edu.al](mailto:sonila.piri@unitir.edu.al) ;  
[alnida.koroshi@unitir.edu.al](mailto:alnida.koroshi@unitir.edu.al)

**OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:*

Për nivelin A2 të gjuhës:

- Të kuptojë elementët kryesorë të një bashkëbisedimi të qartë në gjuhën italiane standarte për çështje që i nevojiten.
- Të kuptojë thelbin e programeve radiofonike dhe televizive në lidhje me çështje të aktualitetit ose për tema në interesin e tij personal ose profesional, mjafton që biseda të jetë relativisht e lehtë ose e qartë.
- Të konsultojë materiale nga burime të ndryshme bibliografike dhe internetit për të pasuruar aftësitë e tij informative dhe gjuhësore për gjuhën italiane.
- Të identifikojë argumentin e një diskutimi që zhvillohet në prani të tij, mjafton të flitet qartë dhe me një theks të qartë. etj.

Për nivelin B1 të gjuhës:

- Të kuptojë informacione të qarta rreth çështjeve të zakonshme të lidhura me jetën e përditshme, ku ligjërata shprehet qartë në një kontekst kryesisht familjar.
- Të kuptojë çështjet kryesore të një ligjërate të qartë në gjuhën standarte e që trajton çështje familjare të punës, shkollës, kohës së lirë etj., përfshirë edhe tregime të shkurtra.
- Të ndjekë e të kuptojë pikat kyçe të një diskutimi të gjatë që zhvillohet në prani të tij, që ligjërohet në gjuhën standarte dhe me një theks të qartë.
- Të kuptojë përmbajtjen informuese të pothuajse të gjitha materialeve audio ose multimediale, që trajtojnë argumenta të interesit vetjak e që janë të shprehura në gjuhën standarte. etj

*Rezultatet e të nxënit:*

- Aftësia të dëgjojë, të kuptojë e të përvetësojë tekste të nivelit A2-B1 sipas Kuadrit Evropian të Referimit të Gjuhëve, të ligjëruara në gjuhë italiane.
- Përvetësimi i elementëve gjuhësore, leksikorë, gramatikore, komunikues, pragmatikë, kulturorë etj., të nivelit A2-B1.

- Zhvillimi i kompetencës receptive në lidhje me tekste të ndryshme gjuhësore sipas niveleve të sipërpërmendura.
- Kompetencat e ndërlidhura me atë të dëgjimit: të kuptuarit e tekstit dhe të ligjërit.